



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2023

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 8, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve dhe me aktin nr. 1615 Prot., datë 01.03.2023, referuar nenit 14§2§b të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Lidhur me pyetjen e parë nëse janë hartuar Termat e Referencës për krijimin e regjistrit për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, ju informojmë se Termat e Referencës për *“Dokumentin e dizenjimit dhe specifikimet teknike të sistemit për regjistrin elektronik kombëtar të OJF-ve”* janë përgatitur në kuadër të projektit të financuar nga BE: *“Mbështetje për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Politikën Qeverisëse drejt një Mjedisi më Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019-2023”*, me Kontratën Specifike Nr. 2019/413554 (Projekt).

Përsa i përket pyetjes suaj, nëse janë bërë publike Termat e Referencës për krijimin e regjistrit për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, ju informojmë se Këshillit të Lartë Gjyqësor, në bazë të ligjit 162/2020, “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 15, pika 3 dhe 41, të VKM nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ka publikuar Termat e Referencës si pjesë e dokumenteve standarde të tenderit në Agjencinë e Prokurimit Publik (www.app.gov.al). Referuar statusit të procedurës së prokurimit të finalizuar me nënshkrim kontrate, në sistemin elektronik të APP-së, procedura është arkivuar në bazë të ligjit dhe sipas udhëzimit të APP-së.

Lidhur me pyetjen me konsultimet e kryera mbi përmbajtjen e regjistrit dhe sa organizata jofitimprurëse kanë marrë pjesë, ju informojmë se me anë të VKM nr. 94, datë 9.2.2022 “Për miratimin e rregullave të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, që regjistrohen në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse, për dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, si dhe për nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara”, janë përcaktuar rregullat e detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, që regjistrohen në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse, për dhënësit e

informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, si dhe për nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara në regjistrin elektronik të organizatave jofitimprurëse.

Ky vendim përcakton të dhënat që duhet të përmbajë regjistri elektronik i organizatave jofitimprurëse, në lidhje me themelimin, fushën e veprimtarisë dhe çregjistrimin e organizatave jofitimprurëse, çdo ndryshim në status dhe formën e organizimit të tyre, të dhëna që i përkasin atyre lidhur me përfaqësimin, si dhe të dhëna të tjera të parashikuara me ligj.

Institucioni përgjegjës për projekvendimin, është Ministria e Drejtësisë. Në këto kushte konsultimet nuk janë kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu, ju sjellim në vëmendje se Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për krijimin e regjistrit elektronik të organizatave jofitimprurëse. Ky regjistër pas krijimit do të administrohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore. Duke qenë se konsultimet publike nuk janë kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, nuk kemi informacion nëse rekomandimet janë marrë në konsideratë.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!